

VENDIM
Nr. 3, datë 27.3.2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.12, DATË 16.10.2018, TË KOMITETIT PËR
ZHVILLIMIN E RAJONEVE, “PËR SHPËRNDARJEN E FINANCIMIT PËR PROJEKTE
TË REJA, THIRRJA II, PËR VITIN 2018, PËR GRANTIN ‘ARSIMI’”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, dhe të aneksit 3, të ligjit nr.99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve

VENDOSI:

1. Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr.12, datë 16.10.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja II, për vitin 2018, për grantin ‘Arsimi’”, bëhen ndryshimet sipas tabelës 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Ngarkohen ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë dhe ministri i Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYETARI
Erion Braçe

Zëvendëskryeministri	zëvendëskryetar;
Ministri i Financave dhe Ekonomisë	anëtar;
Ministri i Arsimit, Sportit dhe Rinisë	anëtar;
Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	anëtar;
Ministri i Kulturës	anëtar;
Ministri i Brendshëm	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Bashkive të Shqipërisë	anëtar;
Kryetari i Shoqatës për Autonomi Vendore	anëtar;
Kryetari i Shoqatës së Qarqeve të Shqipërisë	anëtar.

Tabela 1. Në tabelën 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 12, datë 16.10.2018, të Komitetit për Zhvillimin e Rajoneve, “Për shpërndarjen e financimit për projekte të reja, thirrja II, për vitin 2018, për grantin ‘Arsimi’”, projektit nr. 5 i anulohet financimi dhe bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

“Tabela 1. Lista e projekteve të reja, thirrja II për vitin 2018, grantet “Arsimi” (arsimi bazë), me cikël zbatimi 2018–2019”

Nr.	Autoriteti kontraktor	Emërtimi i projektit	Vlera e plotë e projektit (në lekë)	Vlera e financimit nga FZHR-ja për vitin 2018 (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit nga NJQV-ja (në lekë)		
					%	Vlera e plotë e bashkëfinancimit (në lekë)	Vlera e bashkëfinancimit për vitin 2018 (në lekë)
QARKU DURRËS							
5	Bashkia Durrës	Ndërtimi i shkollës 9-vjeçare “Jusuf Puka”	140,000,000	0	0%	0	0